



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 56, Datë 16.02.2021

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN
NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TIRANË, PËR SHTATË POZICIONET
E LIRA TË SHPALLURA ME VENDIMET E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR,
TË DATËS 28.05.2020

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbas shortit për zgjedhjen e relatorëve,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pesë pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 179, nr. 180, nr. 181, nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020 dhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e relatorit për secilën procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë sipas fushave të së drejtës të pozicioneve të lira të shpallura, si më poshtë:
 - a) Për pesë pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile - relator z. Alban Toro;
 - b) Për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale - relatore znj. Marçela Shehu.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR